



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 469/prot.
16

Tiranë më 17.4.2018

VENDIM

Nr. 17, datë 17.4.2018

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Z. _____ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") Formularin e Ankesës nr. 469 Prot., datë 07.03.2018, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*", kundër Autoritetit Publik "Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Ankuesi në cilësinë e kërkuesit, me emailin e datës 19.02.2018 ka kërkuar nga Autoriteti Publik t'i vihet në dispozicion dokumentacioni dhe informacioni i disponueshëm në lidhje me:

1. *Raportin e Oponencës Teknike për hidrocentralet: Vlabona 1, Valbona 2, Valbona 3.*

Autoriteti Publik, me emailin e datës 05.03.2018 i ka kthyer përgjigje kërkuesit brenda afatit të caktuar në Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", duke argumentuar refuzimin e dhënies së informacionit si më poshtë vijon:

Ligji nr. 125/2013 "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar sipas i. Neni 4, pika 1, gërma b) përcakton se, Koncesionet/ partneritetet publike private mund të jepen për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve për sektorët dhe qëllimet e mëposhtme si prodhim dhe shpërndarje e energjisë elektrike dhe energjisë për ngrohje; ii. Neni 13, pika 2, gërma a) përcakton se, "Autoritetet kontraktuese janë ministritë e

linjës": iii. Neni 15 përcakton se "Dispozitat e ligjit të prokurimit publik, që rregullojnë konfidencialitetin, zbatohen edhe për koncesionet/partneritetet publike private të rregulluara me këtë ligj". Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, sipas: i. Neni 25, përcakton se, "Pa cënuar dispozitat e këtij ligji mbi detyrimin për botimin e kontratave të prokurimit dhe informacioneve për kandidatët dhe ofertuesit, sipas neneve 21 e 57 të këtij ligji, autoriteti kontraktor nuk duhet të bëjë publik informacionet e marra nga operatorët ekonomikë, të etiketuara si konfidenciale. Ky lloj informacioni përfshin veçanërisht aspektet teknike, sekretet tregtare dhe informacionet konfidenciale të ofertave".

Kontratat Koncesionare për Hidrocentralet, sipas Neni 27, përcaktojnë se "Secila nga Palët duhet të konsiderojë konfidenciale të gjitha dokumentat dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin këto tregtare apo teknike dhe nuk mund t'ja bëjë të ditura një palë tjetër, të gjitha apo një pjesë të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e palës tjetër, përveç se për qëllimin e përmbushjes së kushteve të kësaj kontrate".

VKM nr. 547, datë 9.8.2006 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore" përcakton se AKBN "Monitoron Kontratat Koncesionare për Hidrocentralet" por nuk është palë në lidhjen e këtyre kontratave.

Bazuar në përcaktimet e mësipërme ligjore dhe me qëllim që mos të dëmtohet shteti shqiptar si palë në kontratat koncesionare, kërkesa duhet të drejtohet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e autoritetit kontraktor (palë në kontratë).

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 469 Prot., datë 07.03.2018 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes me Urdhrin nr. 98, datë 13.03.2018, vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Gjatë inspektimit u konstatua se kërkesa e Z. është depozituar pranë Autoritetit Publik nëpërmjet emailit zyrtar më datë 19.02.2018. Pas kontaktit me koordinatorin për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, u sqarua se kërkesa e Z. i ka kaluar për trajtim Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme dhe Drejtorisë së Monitorimit të Veprave, Marrëdhënieve dhe Dëgjësive me Publikun. Përfaqësuesit e Autoritetit Publik sqaruan grupin e inspektimit se me emailin e datës 05.03.2018 i është kthyer përgjigje kërkuarit, duke argumentuar gjithashtu kufizimet për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Përfaqësuesit e drejtorive përkatëse të Autoritetit Publik informuan grupin e inspektimit se dokumentacioni i kërkuar ndodhet pranë AKBN-së. Gjithashtu sqaruan se: "Oponenca Teknike është material teknik i shqyrtuar nga grupi teknik i OT, krijuar me urdhër Ministri me nr.130, datë 20.03.2014 si dhe rregullores së funksionimit të grupit të OT-së. Grupi i OT funksionon si organ teknik i cili shqyrton dokumentacionin teknik të propozuar nga kompania koncesionare si skema më e mirë e mundshme për shfrytëzimin e objektivit të kontratës koncesionare. Duke u bazuar në sa më lart, si dhe në nenin e konfidencialitetit të kontratës koncesionare për informacionin teknik, nuk është e mundur dhënia e oponencës teknike personit të interesuar".

Nga ana e grupit të inspektimit u kërkua rivlerësimi i kërkesës për informacion në përputhje me nenin 17/6 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", në të cilin parashikohet se "Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim". Pasi u njohën me përkufizimin e nenit të sipërcituar, përfaqësuesit e Autoritetit Publik morën përsipër rivlerësimin e kërkesës për informacion brenda datës 16.03.2018.

Pas parashtrimit të fakteve u hartua procesverbali i cili u nënshkrua pa vërejtje nga ana e përfaqësuesve të Autoritetit Publik.

Me shkresën nr. 2981/1 Prot., datë 20.03.2018, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke vënë në dispozicion të kërkuarit një informacion të përmbledhur lidhur me objektin e kërkesës për informacion, si më poshtë vijon: "- Kontrata Koncesionare e formës "BOT" është nënshkruar midis METE-s (MIE sot) dhe shoqërisë "Valbona Project Company" sh.p.k, me Nr.5884 Rep., dhe Nr. 1005 Kol., datë 15.08.2013, me objekt ndërtimin në lumin e Valbonës të 9-të hidrocentraleve me parametra hidroenergjitik si vijon: fuqi e instaluar – 51 040 kW dhe prodhim vjetor të energjisë 245 726 989 kwh; - Relacioni i Oponencës Teknike për projektin e zbatimit të paraqitur nga shoqëria koncesionare (që është rekomanduar të miratohet nga Autoriteti Kontraktor), ka trajtuar një skemë të re, respektivisht nga projekt ideja në studimin e fisibilitetit, që është pasqyruar në kontratën e koncesionit. Në projektin e ri numri i hec- eve reduktohet nga 9 në 3 impiante që parashikoheshin në kontratën koncesionare, me parametrat hidroenergjitik si vijon: fuqi të instaluar 44 620 kW dhe prodhim vjetor i energjisë 166 148 060 kWh.

Në vijim të inspektimit pranë Autoritetit Publik, me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" në të cilin citohet se "Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale... Kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve", me shkresën nr. 469/3 Prot., datë 26.03.2018, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore, e cila u zhvillua me prezencën e ankuesit Z. nga njëra anë dhe përfaqësuesit e Autoritetit Publik nga ana tjetër.

Gjatë seancës, ankuesi dhe përfaqësuesit e Autoritetit Publik rikonfirmuan qëndrimet e tyre të reflektuara në aktet shkresore të trajtuara më sipër.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se pretendimet për mos vënien në dispozicion të dokumentacionit nuk qëndrojnë.

Autoriteti Publik pretendon se: "Monitoron Kontratat Koncesionare për Hidrocentralet" por nuk është palë në lidhjen e këtyre kontratave. Rrjedhimisht kërkuari duhet të drejtohet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e autoritetit kontraktor (palë në kontratë). Ky pretendim nuk qëndron pasi Autoriteti Publik është prodhues dhe mbajtës i informacionit të kërkuar dhe bazuar në nenin 1 pika 1 e ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", në të cilin citohet se: "Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me

informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike”, mjafton që Autoriteti Publik të disponojë këtë informacion dhe rrjedhimisht ka detyrimin ligjor për ta vënë në dispozicion të kërkuarit.

Arsyetimi lidhur me refuzimin e informacionit duke cituar “*Konfidencialitetin*”, bie poshtë pasi nuk provohet që dokumentacioni i kërkuar është tërësisht konfidencial. Në nenin 4, pika 3 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575 datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncension/partneritet publik privat” i ndryshuar, përcaktohet ndër të tjera se: “*Studimi i fizibilitetit për koncesionet/PPP për HEC-et hartohet nga komisioni i koncesionit/PPP, pas marrjes së opionencës teknike shtetërore nga strukturat përgjegjëse të ngarkuara për të bërë këtë opionencë*”.

Pra, në përputhje me përcaktimin e këtij neni, opionenca teknike kryhet nga strukturë përgjegjëse shtetërore, fakt i cili bën që kjo strukturë si dhe informacioni i prodhuar prej tyre të jenë objekti i Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit “*informacion publik konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, “*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*”.

Gjithashtu, neni 14, pika 2 e Vendimit të cituar më sipër përcakton ndër të tjera se: “*Para nisjes së procedurës së përzgjedhjes, propozuesit do t’i kërkohej të identifikojë në mënyrë specifike pronësinë intelektuale, që lidhet me zgjidhjet teknike ose teknologjitë e reja, të cilat ata duan të mbrojnë. Klasifikimi i gjithë dokumentacionit të propozimit si sekret, nuk është i pranueshëm.*”

Në frymën e nenit 17 pika 6 e Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit “*...Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim*”, si dhe në bazë të identifikimit nga propozuesi të pjesëve të dokumentacionit të klasifikuar si konfidencial në përputhje me nenin 14, pika 2 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575 datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncension/partneritet publik privat” i ndryshuar, Komisioneri vlerëson se Autoriteti Publik duhet të kishte kufizuar pjesët e raportit të opionencës teknike të cilat i nënshtrohen kufizimeve të trajtuara më sipër, duke vënë në dispozicion të kërkuarit pjesën tjetër të tij.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Z. _____ ndaj Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative' i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankimit nr. 469 Prot., datë 07.03.2018 të Z. _____, kundër Autoritetit Publik "Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar (*Raportin e Oponencës Teknike për hidrocentralet: Vlabona 1, Valbona 2, Valbona 3*), brenda datës 26.4.2018.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
4. Ky vendim u shpall sot në datë 17.4.2018.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

